



|  |  |                                  |                                   |
|--|--|----------------------------------|-----------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar /<br>Primjeno / Prodato /<br>Received / Delivered | 15.08.2023                             | 3                                | viti /<br>god /<br>year           |
| Organ / Njësia /<br>Organ / Jedinica /<br>Org. / Unit                | Nr. Prot. /<br>Br. Prot. /<br>Prot. No | Shtesa /<br>Prilog /<br>Appendix | Sasia /<br>Kolicina /<br>Quantity |
| SKIMSHICK  | 5680/2023                              |                                  | 113                               |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1046/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari –kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1046/2023 të datës 31.07.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1046/2023 e datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Malishevës, sipas Akt Emërimit me numër Nr.01/159 të datës 24.01.2012 në pozitën e punës “Kontabilist” në Drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, më datë 31.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5454/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Komunes së Malishevës, lidhur me kategorizimin e pozitës së tij të punës në Kategorinë Profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 03.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Malishevës, ndërsa me datë 08.08.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin me numër Nr.01/159 të datës 24.01.2023 ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Kontabilist" në Drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Buxhet me koeficient të pagës, pesë (6), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesi, me datë 31.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5454/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Malishevës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 3, përkundër se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore për Kategorinë Profesionale 2, të parashikuara në Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Institucioni përkatësisht, Komuna e Malishevës më datë 10.03.2023 ka dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB, kërkesën me numër Nr.01/378 për korrigjimin e koeficienteve të pagave për zyrtarët e Zyrës Komunale të Gjendjes Civile në Komunën e Malishevës e që lidhet edhe me pretendimin ankimor të ankuesit, ndërsa Kolegji i Këshill pas administrimit të shkresave të lëndës nuk ka gjetur asnjë një shkresë konkretisht përgjigje nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB që ka vendosur në lidhje me këtë çështje konkrete, kurse ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar më datë 31.07.2023, ende pa marrë ndonjë përgjigje zyrtare nga DMZP-ja.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Malishevës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Institucionet e Administratës Publike janë obliguar që të

përgadisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë „Profesionale 2” është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1046/2023.*

Kaltrina Avdullahi Prenaj

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

